



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 149, datë 08.04.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË MBARIMIT TË STATUSIT TË MAGJISTRATIT
PËR Z. {...}, GJYQATAR PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 41, 64, 90 dhe 94 të Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës për revokimin e kërkesës së paraqitur për heqje dorë nga statusi i magjistratit. nga gjyqtari {...}, me propozim të relatores znj. Shehu,

VENDOSI

1. Përfundimin e procedurës së mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të tërheqjes së tij nga kjo kërkesë.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR